

# Statistikat e Krimeve

## Tremujori i dytë 2017


**Tirana, 21 Korrik 2017:** Në tremujorin e dytë 2017 janë kryer 8.393 vepra penale, rreth 6,1 % më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Gjatë tremujorit të dytë 2017 janë regjistruar 8.855 autorë të veprave penale, të cilët janë 8,3 % më pak, krahasuar me tremujorin e dytë 2016.

Ndaj totalit të veprave penale, pjesën më të madhe e zënë “Krimet kundër autoritetit të shtetit” me 39,6 %, “Krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” me 38,2 % dhe “Krimet kundër personit” me 20,1 %.

**Tab. 1 Veprat penale dhe autorët**

Grupveprat penale	T2 - 2016		T2 - 2017	
	Vepra të evidentuara	Autorë	Vepra të evidentuara	Autorë
Krime kundër njerëzimit	0	0	0	0
Vepra penale kundër personit	1.840	2.193	1.688	1.989
Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	3.293	3.220	3.205	2.928
Vepra penale kundër mjedisit	80	93	42	54
Krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues	0	0	3	11
Krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera	0	0	0	0
Aktet terroriste	0	0	5	7
Krime kundër autoritetit të shtetit	3.670	4.041	3.321	3.676
Vepra penale kundër drejtësisë	53	111	87	129
Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve	0	0	40	53
Vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale	1	3	2	8
Gjithsej	8.937	9.661	8.393	8.855

**Fig.1 Veprat penale dhe autorët**




**Për publikim 21/07/2017**

**Vepra penale kundër personit**

Gjatë tremujorit të dytë 2017 janë kryer 1.688 vepra penale kundër personit, duke pësuar ulje me 8,3 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2016. Numri i autorëve të krimeve kundër personit, në këtë periudhë është 1.989, dhe përbën 22,5 % të totalit të autorëve. Gjatë tremujorit të dytë 2017, numri i autorëve të kësaj vepre penale është ulur me 9,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


**Fig. 2 Veprat penale dhe autorët kundër personit**



**Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike**

Në tremujorin e dytë 2017 janë kryer 3.205 vepra penale “*Krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike*”, duke pësuar ulje me 2,7 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2016. Autorët e tyre janë 2.928, rreth 9,1 % më pak se në të njëjtën tremujor të një viti më parë dhe përbëjnë 33,1 % të totalit. Në këto vepra penale, seksioni *Vjedhjet e pasurisë* zë 37,5 % të totalit. Krahasuar me tremujorin e dytë 2016, gjatë këtij tremujori vjedhjet e pasurisë kanë pësuar një ulje me 26,3 %.

**Fig.3 Veprat penale dhe autorët kundër pasurisë dhe sferës ekonomike**




**Veprat penale kundër autoritetit të shtetit**

Në tremujorin e dytë 2017 janë kryer 3.321 vepra penale, me një rënie prej 9,5 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2016. Numri i autorëve gjatë tremujorit të dytë 2017, është 3.676, duke shënuar një ulje me 9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, përbëjnë përqindjen më të madhe të veprave kundër autoritetit të shtetit, me rreth 76,6 %, duke regjistruar një ulje prej 13,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


**Fig.4 Veprat penale kundër autoritetit të shtetit**



**Masat e sigurisë**

Gjatë tremujorit të dytë 2017, numërohen 8.855 masa sigurie për autorë të veprave penale, nga 9.661 që ishin në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke pësuar një ulje me 8,3 %.

**Fig.5 Masat e sigurisë të ndërmarra për autorët e veprave penale**



**Tab. 2 Veprat penale kundër personit**

Vepra penale kundër personit	T2 - 2016		T 2 - 2017	
	Vepra të evidentuara	Autorë	Vepra të evidentuara	Autorë
<b>Krime kundër jetës</b>	<b>417</b>	<b>455</b>	<b>401</b>	<b>444</b>
<i>Vrasje</i>	13	21	19	17
<i>Vrasje nga pakujdesia</i>	0	0	0	0
<i>Vrasje mbetur tentativë</i>	26	30	35	39
<i>Kanosje serioze për hakmarje ose gjakmarrje</i>	3	2	4	4
<i>Kanosja</i>	375	402	343	384
<b>Kundër shëndetit</b>	<b>356</b>	<b>493</b>	<b>348</b>	<b>455</b>
<i>Plagosje e lehtë me dashje</i>	317	438	313	415
<i>Mjekim pakujdesshëm</i>	0	0	3	4
<i>Të tjera</i>	39	55	32	36
<b>Krime seksuale</b>	<b>31</b>	<b>32</b>	<b>22</b>	<b>20</b>
<i>Tentativë mardhënie seksuale</i>	1	1	2	2
<i>Të tjera</i>	30	31	20	18
<b>Vepra penale kundër lirisë së personit</b>	<b>30</b>	<b>39</b>	<b>24</b>	<b>28</b>
<i>Shtërngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë</i>	16	28	8	8
<i>Trafikimi i personave</i>	12	9	14	17
<i>Të tjera</i>	2	2	2	3
<b>Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit</b>	<b>32</b>	<b>67</b>	<b>41</b>	<b>50</b>
<i>Ushtrim prostitucioni</i>	4	21	9	21
<i>Shfrytëzim prostitucioni</i>	20	28	26	22
<i>Mbajtja e lokaleve për prostitucion</i>	8	18	6	7
<b>Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes</b>	<b>470</b>	<b>502</b>	<b>380</b>	<b>413</b>
<i>Trafikimi i të miturit</i>	5	4	5	7
<i>Dhuna në familje 130/a</i>	414	441	335	363
<i>Të tjera</i>	51	57	40	43
<b>Vepra penale kundër lirisë së besimit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Të tjera kundër personit</b>	<b>504</b>	<b>605</b>	<b>472</b>	<b>579</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>1.840</b>	<b>2.193</b>	<b>1.688</b>	<b>1.989</b>

**Tab. 3 Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike**

Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	T2 - 2016		T 2 - 2017	
	Vepra të evidentuara	Autorë	Vepra të evidentuara	Autorë
<b>Vjedhje pasurie</b>	<b>1.631</b>	<b>1.369</b>	<b>1.202</b>	<b>845</b>
<i>Vjedhje banke</i>	0	0	0	0
<i>Tentativë vjedhje banke</i>	0	0	1	1
<i>Vjedhje banese</i>	309	239	266	64
<i>Vjedhje kompanie firme</i>	9	10	16	8
<i>Vjedhje lokale tregtie</i>	141	88	124	80
<i>Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën</i>	35	41	29	34
<i>Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike</i>	358	363	40	46
<i>Vjedhja me dhunë</i>	24	29	32	30
<i>Vjedhje me dhunë mbetur tentativë</i>	9	14	5	4
<i>Trafikimi i mjeteve motorike</i>	61	73	37	38
<i>Tentativë vjedhje</i>	105	85	118	84
<i>Vjedhje me armë</i>	4	12	2	3
<i>Vedhje me armë mbetur tentativë</i>	1	2	1	0
<i>Vjedhje me pasojë vdekjen</i>	0	0	0	0
<i>Trafikim i veprave të artit</i>	3	4	1	1
<i>Vjedhje automjetesh</i>	47	22	73	16
<i>Vjedhje të tjera</i>	525	387	457	336
<b>Mashtrimet</b>	<b>147</b>	<b>197</b>	<b>199</b>	<b>220</b>
<i>Mashtrime</i>	114	158	172	186
<i>Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit</i>	1	0	1	1
<i>Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale</i>	32	39	26	33
<b>Shkatërrimi i pronës</b>	<b>290</b>	<b>255</b>	<b>317</b>	<b>248</b>
<i>Shkatërrimi i pronës me zjarr</i>	38	12	46	8
<i>Shkatërrimi i pronës me eksploziv</i>	12	5	16	8
<i>Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera</i>	240	238	255	232
<b>Vepra në lidhje me ushtrim të palicënsuar të veprimtarive bankare dhe financiare</b>	<b>14</b>	<b>13</b>	<b>6</b>	<b>11</b>
<b>Krime në fushën e doganave</b>	<b>75</b>	<b>90</b>	<b>94</b>	<b>109</b>
<i>Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve</i>	8	11	19	22
<i>Të tjera në fushën e doganave</i>	67	79	75	87
<b>Veprat në lidhje me tatimet dhe taksat</b>	<b>152</b>	<b>158</b>	<b>218</b>	<b>239</b>
<b>Veprat në fushën e fallsifikimeve</b>	<b>279</b>	<b>343</b>	<b>261</b>	<b>274</b>
<i>Fallsifikimi i leternjof.pasaportave, vizave</i>	48	57	72	77
<i>Të tjera në fushën e fallsifikimeve</i>	231	286	189	197
<b>Vepra penale që çënojnë regjimin juridik</b>	<b>402</b>	<b>448</b>	<b>696</b>	<b>754</b>
<i>Ndërtimi i paligjshëm</i>	402	448	696	754
<b>Të tjera kundër pronës dhe në sferën ekonomike</b>	<b>303</b>	<b>347</b>	<b>212</b>	<b>228</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>3.293</b>	<b>3.220</b>	<b>3.205</b>	<b>2.928</b>

**Tab. 4 Veprat penale kundër autoritetit të shtetit**

Krime kundër autoritetit të shtetit	T2 - 2016		T 2 - 2017	
	Vepra të evidentuara	Autorë	Vepra të evidentuara	Autorë
<b>Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore nga shtetasit</b>	<b>629</b>	<b>875</b>	<b>601</b>	<b>731</b>
<i>Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik</i>	138	145	108	119
<i>Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik</i>	201	277	184	223
<i>Në fushën e korrupsionit</i>	290	453	309	389
<b>Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike</b>	<b>2.935</b>	<b>3.048</b>	<b>2.546</b>	<b>2.758</b>
<i>Trafikimi i armëve dhe i municionit</i>	8	9	8	7
<i>Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive</i>	2	1	1	4
<i>Prodhimi dhe shitja e narkotikëve</i>	361	471	415	507
<i>Trafikimi i narkotikëve</i>	18	29	46	58
<i>Kultivimi i bimëve narkotike</i>	325	150	124	125
<i>Të tjera në fushën e drogës</i>	8	12	10	12
<i>Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale</i>	106	132	87	92
<i>Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor</i>	592	573	558	553
<i>Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi</i>	93	52	59	40
<i>Largimi nga vendi i aksidentit</i>	712	714	589	598
<i>Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit</i>	6	22	16	48
<i>Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit</i>	291	368	263	288
<i>Vepra në fushën e teknologjisë</i>	55	18	59	23
<i>Të tjera kunder rendit dhe sigurisë</i>	358	497	311	403
<b>Vepra penale kundër sekretit dhe kufijëve shtetëror</b>	<b>106</b>	<b>118</b>	<b>174</b>	<b>187</b>
<i>Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror</i>	90	96	158	166
<i>Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve</i>	16	22	16	21
<b>Gjithsej</b>	<b>3.670</b>	<b>4.041</b>	<b>3.321</b>	<b>3.676</b>

**Tab. 5 Masat e sigurisë të ndërmarra për autorët e veprave penale**

	Masat e sigurisë	
	T 2 2016	T 2 2017
Arrestuar	2.737	2.148
Ndaluar	696	367
Gjykim i lirë	5,524	5.641
Larguar	683	685
Të ndryshime	21	14
<b>Gjithsej</b>	<b>9.661</b>	<b>8.855</b>

# Metodologjia

Statistikat e krimeve pasqyrojnë të dhëna mbi veprat penale të evidentuara dhe personat e dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Grupimi i veprave penale është bërë sipas ndarjes referuar Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, respektivisht në 11 kapituj dhe duke u ndalur në seksionet e çdo kapitulli, ku janë evidentuar vepra penale gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017 dhe 2016.

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara i referohen artikujve të Kodit Penal dhe jo ngjarjes, pasi në një ngjarje mund të gjejmë më shumë se një element kriminal të veprës penale.

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, jo në gjykime të cilat janë në kompetencat e organeve të drejtësisë për të dhënë verdiktin. Të dhënat mbi autorët gjithashtu përfshijnë edhe të dhëna mbi masat e sigurimit. Këto masa sigurimi i'u nënshtrohen personave në qoftë se në ngarkim të tyre ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.

## **Përkufizime:**

**Vepra penale:** Veprat me të cilat çënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundravajtje penale.

**Vepra penale kundër personit:** Përfshihen veprat penale kundër jetës, shëndetit, lirisë, moralit dhe dinjitetin, veprat penale kundër familjes, martesës, fëmijëve dhe kundër lirisë së besimit.

**Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike** përfshijnë vepra të tilla si: Vjedhjet e pasurisë, mashtrimet, krime në fushën e doganave dhe tatim-taksave, vepra që çënojnë regjimin juridik.

**Veprat penale kundër autoritetit të shtetit** përfshijnë vepra të tilla si: kundër veprimtarisë shtetërore nga shtetasit, kundër rendit dhe sigurisë publike si dhe kundër sekretit dhe kufijëve shtetëror, ku secili seksion përmban në vetvete një sërë aktesh të tjera.

**Autorë:** Persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejon që të ndodh një vepër penale pra shkakton pasojën e veprës penale. Autorët mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale ndërkohë fëmijët nën 14 vjeç janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale.

**Vepra të raportuara:** vepra të raportuara në polici ose që policia ka njohuri mbi to në mënyra të tjera.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara dhe autorët janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.